

Drejtoria e Regjistrimit

It

SHOQËRIA TREGËTARE "Kompleks Ndërtimi 96"

(në likuidim)

LIKUJDATORI

SH.P.K.

6200

13.4.2011

Korçë, më 10.04.2011

Lënda: Kërkesë për publikimin në Faqen e Internetit të Q.K.R-së të ftesës të dytë për kreditorët e shoqërisë "Kompleks Ndërtimi 96" Sh.p.k Korçë me NIPT J74706045F (shoqëri në likuidim e sipër)

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Tiranë

Shoqëria Tregëtare "Kompleks Ndërtimi 96" është në procesin e likuidimit të saj. Vendimi për prishjen dhe caktimin e likujdatorit është depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 10.03.2011 dhe është vendosur në publikimet tuaja "gjendja e regjistrimit" me status "shoqëri në likuidim e sipër".

Në bazë të nenit 195 të Ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", likujdatori i shoqërisë duhet të ftojë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Sipas këtij neni, publikimi i ftesës bëhet "...në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit".

Në datën 10.03.2011 kemi bërë dërgimin e ftesës së parë për kreditorët në rrugë postare dhe po vazhdojmë me ftesën e dytë, sipas hapave që kërkon ligji.

Bashkangjitur do të gjeni ftesën e dytë që ne kemi përgatitur për publikun.

Jemi në pritje të publikimit nga ana juaj.

Duke ju falenderuar

Likujdatori i Shoqërisë "Kompleks Ndërtimi 96" Sh.p.k



Ilda EKONOMI



SHOQËRIA TREGËTARE “ Kompleks Ndërtimi 96 ” Sh.p.k Korçë
(në likuidim)
LIKUJDATORI

FTESË PËR KREDITORËT E SHOQËRISË “ Kompleks Ndërtimi 96 ” SH.P.K
(Njoftimi i dytë)

Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë “ Kompleks Ndërtimi 96 ” për prishjen e saj është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 10.03.2011 dhe ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit. Po me këtë vendim është emëruar edhe likujdatori i shoqërisë, znj. Ilda EKONOMI me adresë : Rr. Ndre Mjeda, Lagja 7 Pall i Ri (në krah të Bonbonerisë) Korçë, e cila ka të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr, 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

Shoqëria “Kompleks Ndërtimi 96” Sh.p.k. që Likujdohet ka të dhënat që vijojnë:

E themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe e identifikuar me NIPT-in nr. **J 74706045 F**.

Kapitali i saj i regjistruar aktualisht është 100.000 lekë dhe zotërohet nga

1. Nesti Xega	5%
2. Leonidas Touroutoglou	22.5 %
3. Petros Touroutoglou	22.5 %
4. Stiljano Kapeli	22.5%
5. Kostandin Xega	5%
6. Kostantinos Kapelis	<u>22.5%</u>
	100%

ortaket themelues te saj. Selia zyrtare e Shoqërisë është në qytetin e Korçës.

Ftesa për kreditorët e Shoqërisë.

Bazuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” neni 195, likujdatori i shoqërisë nëpërmjet publikimit, fton kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj, dy herë radhazi me një interval kohor prej 30 ditësh.

Në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit është bërë publikimi i parë i ftesës dhe pas një muaji po përsëritet e njëjta ftesë.

Pretendimet tuaja duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të dytë të publikuar në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Zyrën e likujdatorit me adresë: Rruga Ndre Mjeda, Lagja Nr 7 Pallati i Ri (në krah të Bonbonerisë) Korçë ose me numra kontakti

tel (0824) 250 070 dhe cel. 069 20 56 865.

Likujdatori i Shoqërisë “ Kompleks Ndërtimi 96 ” Sh.p.k

